



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

INFORMATË

PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR 2019/20

Hyrje

Informata për fillimin e vitit të ri shkollor 2019/20 është përgatitur nga *Drejtoria e Arsimit*, për të gjitha institucionet arsimore, për arsimin parauniversitar, në komunën e Mitrovicës.

Kjo informatë përfshinë:

I. Të dhënat e përgjithshme

- Numri i nxënësve sipas niveleve shkollore;
- Numri i nxënësve sipas strukturës etnike;
- Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta.

II. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2019/20

- Infrastruktura shkollore;
- Furnizimi me lëndë djegëse;
- Furnizimi me tekste shkollore;
- Trajnimi i mësimdhënësve;
- Të tjera.

I. Të dhënat e përgjithshme

Vitin e ri shkollor 2019/20 e kanë filluar 16,533 nxënës, ku prej tyre në institucione arsimore publike janë 16,159 nxënës ndërsa në institucionet arsimore private janë 374 nxënës. Këta nxënës i vijnë në mesimet në institucione arsimore të mëposhtme:


- 1 Institucion Parashkollor (publik);
- 3 Institucione Parashkollore (private);
- 28 Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta (publike);
- 11 Paralele të ndara të Shkollave Fillore (publike);
- 1 Shkollë e Mesme e Ulët dhe Shkollë e Mesme e Lartë (private);
- 5 Shkolla të Mesme të Larta (publike);
- 1 Shkollë për fëmijë me nevoja të veçanta - Qendër Burimore (publike).

Numri i nxënësve sipas niveleve shkollore

Sipas të dhënave zyrtare të regjistruara në SMIA, numri i nxënësve në nivelin parashkollor është 610 nxënës, në nivelin parafillor 1,069 nxënës, në nivelin fillor 6,016 nxënës, në nivelin e mesëm të ulët 4,669 nxënës dhe në nivelin e mesëm të lartë 4,169 nxënës.

Nga numri i përgjithshëm i nxënësve që janë përfshirë në të gjitha nivelet shkollore, numri më i madh i nxënësve është në arsimin fillor (36% e numrit të përgjithshëm), ndërsa numri më i vogël i nxënësve është në arsimin parashkollor (4% e numrit të përgjithshëm).

Përqindja e përfshirjes së nxënësve nëpër nivele shkollore



Të dhënat e tjera, sipas grupeve/klasave për nivele shkollore, mund t'i shihni në tabelarin e mëposhtëm:

Grupmosha/Klasa/Niveli	Nr. i grupeve / paraleleve	Numri i nxënësve		
		M	F	GJ
Grupmosha 1-2 vjeç	7	34	45	79
Grupmosha 2-3 vjeç	7	71	37	108
Grupmosha 3-4 vjeç	6	59	65	124
Grupmosha 4-5 vjeç	10	104	92	196
Grupmosha 5-6 vjeç	4	60	43	103
Arsimi Parashkollor (çerdhe) - Gjithsej	34	328	282	610
Arsimi Parafillor (Klasa përgatitore) - Gjithsej	46	577	492	1069
Klasa 1	81	625	598	1223
Klasa 2	78	575	638	1213
Klasa 3	72	618	607	1225
Klasa 4	72	602	557	1159
Klasa 5	70	606	590	1196
Arsimi Fillor (Klasa 1-5) - Gjithsej	373	3026	2990	6016
Klasa 6	73	564	564	1128
Klasa 7	66	571	588	1159
Klasa 8	71	634	578	1212
Klasa 9	62	592	578	1170
Arsimi i Mesëm i Ulët (Klasa 6-9) - Gjithsej	272	2361	2308	4669
Klasa 10	56	724	724	1448
Klasa 11	57	618	699	1317
Klasa 12	58	617	787	1404
Arsimi i Mesëm i Lartë (Klasa 10-12) -Gjithsej	171	1959	2210	4169
Gjithsej nxënës	896	8251	8282	16533

Numri i nxënësve sipas strukturës etnike

Siç jeni në dijeni, mësimi në komunën tonë organizohet edhe në gjuhën boshnjake (ShFMU “Bedri Gjinaj”; Gjimnazi “Frang Bardhi”) dhe në gjuhën turke në ShFMU “A. Z. Çajupi”. Nxënësit e minoritetit Ashkalinj e vijnë në mësimin në gjuhën shqipe dhe janë të integruar në klasat e rregullta me nxënësit shqiptar. Pra, nuk janë të segreguar siç është rasti i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian të cilët në komunën e Mitrovicës së veriut janë të segreguar-janë të ndarë në klasa të veçanta-klasa vetëm me nxënës të minoriteteve.

Përkatësia etnike	Numri i nxënësve
Shqiptarë	16439
Turq	15
Boshnjakë	20
Ashkalinjë	56
Tjetër...	5
Gjithsej	16535

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta

Përfshirja e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta të komunës sonë është në rritje nga viti në vit, në të gjitha nivelet shkollore. Numri i nxënësve me nevoja të veçanta që do ta ndjekin mësimin në këtë vit shkollor, në nivel komune është 339 nxënës për të gjitha nivelet shkollore.

Lloji i dëmtimit	Numri i nxënësve
Dëmtime intelektuale	69
Dëmtime në të dëgjuar	7
Dëmtime në të parë	92
Dëmtime fizike	17
Dëmtime të shumëfishta	22
Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	43
Autizëm	10
Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	21
Vështirësi/Çrregullime në të nxënë	45
Deprivimet sociale, kulturore dhe gjuhësore	1
Sindromi Daun	12
Gjithsej	339

Kuptohet, ky numër është i deklaruar nga vetë shkollat në *Bazën e të dhënave zyrtare - SMIA* (Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim).

II. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2019/20

Drejtoria e Arsimit, i ka kryer të gjitha përgatitjet për një fillim sa më të mbarë të vitit të ri shkollor 2019/20, si: rregullimet e nevojshme infrastrukturore, realizimin e disa projekteve kapitale në shkolla, furnizimin me lëndë djegëse, furnizimin me tekste shkollore, etj.

Infrastruktura shkollore

Sipas nevojave të shkollave, DKA ka bërë rregullimet e nevojshme infrastrukturore. Janë gëlqerosur të gjitha ato shkolla që kanë pasur nevojë të gëlqerosen, si; Avni Shabani, Bislim Hajdari, Ismail Qemali, Mehë Uka, Xhevat Jusufi, Shemsi Ahmeti, etj. Të gjitha shkollat kanë bërë pastrime gjenerale gjatë kohës së pushimit veror dhe kanë realizuar renovime të vogla, të nevojshme. Në vijim po i listojmë disa nga rregullimet që janë bërë në infrastrukturën e shkollave:

- Është bërë rregullimi i nyjeve sanitare në gjimnazin “Frang Bardhi”;
- Renovimi i objektit të ShFMU “Xhevat Jusufi”- Bare (projekti për efqencë-MZHE);
- Realizimi i shkallëve emergjente në ShFMU “Eqrem Çabej”;
- Furnizimi me shtretër në çerdhe;
- Furnizimi me kalda për nxemje në ShFMU “Abdullah Shabani”;

- Furnizimi me kalda për nxemje në ShFMU “Sefedin Smakolli”;
- Rregullimi i pjesëve përcjellëse të kaldasë në disa shkolla;
- Rregullimi i oborreve dhe fushave sportive në çerdhe dhe 10 shkolla: IP “Gëzimi ynë”, ShFMU “Abdullah Shabani”, ShFMU “Aziz Sylejmani”, ShFMU “Bislim Imeri”, ShFMU “Elena Gjika”, ShFMU “Fazli Greiçevci”, ShFMU “Xhevat Jusufi”, ShFMU “Mehë Uka”, ShFMU “Sefedin Smakolli”, ShFMU “Shaban Idrizi”, ShFMU “Trepça”.
- Rregullimi i rrjetit të ujit në ShFMU "Migjeni";
- Furnizimi me inventar shkollor në disa shkolla;
- Ka filluar mësimi në objektin e ri (model) të ShFMU “Ismail Qemali”;
- Ka filluar mësimi në aneksin e ri të shkollës “Sylejman Vokshi”- Broboniq.
- Së shpejti pritet të filloj ndërtimi i objektit të ri të shkollës “Harun Beka” në Gushac;
- Së shpejti pritet të filloj ndërtimi i objektit të Institucionit Parashkollor në Frashër.

Furnizimi i me lëndë djegëse

DKA bënë furnizimin me lëndë djegëse (dru, pelet dhe naftë) për të gjitha institucionet arsimore, duke përfshirë shkollat amë dhe paralelet e ndara. Pra, furnizimi bëhet për 1 institucion parashkollor-çerdhe, 27 shkolla fillore të mesme të ulëta amë dhe 11 paralele të ndara, 5 shkolla të mesme të larta dhe Qendrën Mësimore në Lagjen e Romëve. Deri tani është bërë furnizimi për të gjitha këto institucione, me përjashtim të 4 shkollave që janë në procedurë të furnizimit.

Gjatë këtij viti kemi filluar furnizimin edhe me pelet, pasi që objekti i ri (model) i shkollës “Ismail Qemali” që ka filluar në këtë shtator, e ka sistemin e ngrohjes me pelet.

Në përgjithësi, për ngrohje për këtë vit shkollor 2019/20 janë ndarë 186,336.50 €

Lënda djegëse	Çmimi në €
Dru	122,662.00
Pelet	6,451.20
Naftë	57,223.30
Gjithsej	186,336.50

Shumica e shkollave e kanë sistemin e ngrohjes më dru dhe atë 24 shkolla fillore të mesme të ulëta amë dhe 11 paralele të ndara si dhe 3 shkolla të mesme të larta. Me pelet e kemi vetëm 1 shkollë. Me naftë e kemi 1 institucion parashkollor, 3 shkolla fillore të mesme të ulëta dhe 1 shkollë të mesme të lartë. Në faqen vijuese mund t’i shihni detajet për secilin institucion arsimor.

FURNIZIMI ME LËNDË DJEGËSE (DRU, PELET) PËR INSTITUCIONET ARSIMORE PËR VITIN SHKOLLOR 2019/20			
Institucionet arsimore	Lloji i lëndës djegëse	Njësia	Sasia
"Abdullah Shabani"	Dru	m ³	180
"Arkitekt Sinani"	Dru	m ³	110
"Avni Shabani"	Dru	m ³	30
"Aziz Sylejmani"	Dru	m ³	64
"Bedri Gjinaj"	Dru	m ³	133
"Bislim Hajdari"	Dru	m ³	49
"Bislim Halimi"	Dru	m ³	30
"Bislim Imeri"	Dru	m ³	67
"Dr. Xheladin Deda"	Dru	m ³	245
"Elena Gjika"	Dru	m ³	156
"Elmaz Peci"	Dru	m ³	40
"Fazli Greiçevci"	Dru	m ³	229
"Frang Bardhi"	Dru	m ³	166
"Gj.K. Skëndërbeu"	Dru	m ³	219
"Harun Beka"	Dru	m ³	62
"Ismail Qemali"	Pelet	Ton	29
"Jashar Begu"	Dru	m ³	50
"Jusuf Rexha"	Dru	m ³	75
"Mehë Uka"	Dru	m ³	51
"Migjeni"	Dru	m ³	130
"Musa Hoti"	Dru	m ³	100
"Sefedin Smakolli"	Dru	m ³	48
"Shaban Idrizi"	Dru	m ³	104
"Shemsi Ahmeti"	Dru	m ³	22
"Sylejman Vokshi"	Dru	m ³	45
"Tefta Tashko"	Dru	m ³	158
"Trepça"	Dru	m ³	113
"Xhevat Jusufi"	Dru	m ³	62
Qendra mësimore në Lagjen e Romëve	Dru	m ³	10

FURNIZIMI ME LËNDË DJEGËSE-NAFTË PËR INSTITUCIONET ARSIMORE	
Institucionet arsimore	Shuma e mjeteve €
"A. Z. Çajupi"	9,092.00
"Eqrem Çabej"	9,926.00
"Gëzimi ynë"	21,475.30
"Hasan Prishtina"	9,594.00
"Nonda Bulka"	500.00
"Shemsi Ahmeti"	6,636.00

Furnizimi i me tekste shkollore

MASHT ka bërë furnizimin me tekste shkollore falas për nxënësit e arsimit të obligueshëm edhe për këtë vit shkollor. Furnizimi me tekste shkollore të reja është bërë prej klasës përgatitore deri te klasa e shtatë. Furnizimi këtë vit është bërë me tekstet e reja shkollore sipas kurrikulës së re. Tekstet kanë ardhur në dy kontingjente.

Trajnimi i mësimdhënësve

Në periudhën *korrik-shtator 2019* janë trajnuar *108 mësimdhënës* të cilët në vitin e ri shkollor 2019/20 do të fillojnë për herë të parë ta zbatojnë kurrikulën e re. Nga pasqyrimi tabelar shohim se në të gjitha fushat kurrikulare ka pasur mësimdhënës që janë trajnuar për zbatimin e kurrikulës së re. Numri më i madh i mësimdhënësve që janë trajnuar është në klasën përgatitore dhe arsimin fillor. Në trajnim ka pasur edhe drejtor, zv. drejtor shkollash të cilët e kanë ndjekur trajnimin në fushat përkatëse për të cilat janë të kualifikuar. Përveç trajnimit për kurrikulë nga muaji tetor kanë filluar edhe disa trajnime tjera për mësimdhënësit e arsimit parafillor dhe fillor për ngritjen/zhvillimin e tyre profesional të vazhdueshëm në kuadër të një projekti të EU-së në bashkëpunim me MASHT-in dhe komunat për zbatimin e trajnimit me bazë në shkollë. Këto trajnime do të mbahen një ditë në çdo muaj dhe mësimdhënësit do të fitojnë kredi të cilat do të ju nevojiten për ri-licencim. Në këtë muaj ka filluar edhe trajnimi për udhëheqje arsimore.

Mësimdhënësit që janë trajnuar për Zbatimin e Kurrikulës për vitin shkollor 2019/2020	
Fusha kurrikulare	Nr.
Gjuhët dhe Komunikimi	13
Artet	2
Matematika	5
Shkencat natyrore	8
Shoqëria dhe mjedisi	9
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti	4
Jeta dhe puna	3
Klasa përgatitore dhe arsimit fillor	64
Gjithsej	108